



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 48 Prot

Tiranë, më 13.07. 2007

VENDIM Nr. 8 dt. 19.06.2007

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 19.06.2007, pasi shqyrtoi projektet e miratuara nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

VENDOSI:

1. Miratimin e projekteve:

- Hani i Zagories, Gjirokastrë.
- Teatri i Sofratikës, Gjirokastrë.
- Shërbime (nyje sanitare), në ambientet e Parkut Arkeologjik "Butrint".
- Hamami Durrës.

2. Miratimin në parim të idesë të shfrytëzimit për qëllime kulturore të hapësirës ndërmjet dy blloqeve të ndërtimit, të Rektoratit të Universitetit të Tiranës dhe Institutit të Arkeologjisë, duke ruajtur të paprekur ballin ndërlidhës në formë kollonade dhe kollonadat anësore.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

PROF. DR. YLLI PANGO